

KËRKIME GJUHËSORE

Rafaela MARTETA

NDIKIMI I MEDIAVE TË REJA NË GJUHËN E SHKRUAR RASTI I SHËRBIMIT TË MESAZHEVE TË SHKURTRA TË TELEFONISË CELULARE

Hyrje. Teknologjitë e reja të komunikimit prej vitesh tashmë kanë nxitur forma të reja komunikimi. Në jo pak raste, teksti digjital për shkak të rrjedhshmërisë dhe pakapshmërisë së tij i është nënshtruar vërtetimit të studiuesve si domethënës për fatin e gjuhës së shkruar sot. Në kuadër të ndryshimeve të mëdha shoqërore, kulturore, politike nuk munden dhe nuk duhet të mbeten jashtë rivlerësimit, modifikimit edhe në gjuhën e shkruar. Me ndodhinë dhe përhapjen e teknologjive të reja, që në fillime disa sociologë dhe gjuhëtarë (Abruzzese) kanë shprehur dyshimin, se paradigma alfabetike mund të mos jetë më e aftë, që e vetme të riprodhojë dhe të paraqesë një realitet tashmë të ndërlikuar nga shumëllojshmëria e mjeteve të komunikimit në dispozicion.

Në kontekstin e mediave të reja ka lindur nevoja për një rithemelim teorik të konceptit të komunikimit. Së pari, lind nevoja që komunikimi, apo me saktë, situata komunikative të lexohet jo thjesht si produkt, por si një proces i gjallë. Kjo është një pikënisje e mirë për të trajtuar më me siguri dhe aftësi profesionale universin e mediave të reja dhe ndikimin e tij.

Sociologu i komunikimit Alberto Abruzzese është ndër të parët në Itali, që i është përkushtuar studimit të mediave të reja. Ai bën thirrje për një ridiskutim të praktikës kulturore perëndimore të bazuar në mitin e ruajtjes, mbrojtjes, monumentalizimit të gjuhës së shkruar. Ai mbështet, se alfabeti është vërtetë një instrument hierarkik nëpërmjet të cilit forca e gjuhës merr formë dhe përcaktohet, por edhe ky vetë si instrument ndikohet nga afrimi me format e reja të komunikimit spontan, të nxitura nga zhvillimi i teknologjisë.

Një pasqyrim, megjithëse i natyrës së përgjithshme i është bërë që herët çështjes së ndryshimit të ligjërimit nën ndikimin e valës së teknologjive të reja. Disa autorë, si Ellul dhe Hottois (1977) kanë kritikuar rëndshëm shoqërinë e informacionit, duke e akuzuar atë si shkaktar të varfërimit të ligjërimit. Të tjerë kanë qenë të interesuar të analizojnë, nëpërmjet krahasimit, tiparet e ligjërimit tradicional dhe atij të ndërmjetësuar.

Sms-të mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar. Në epokën e oralitetit “të dytë”¹ (Sparapano 2006) – epoka e “oralitetit të parë”, përfundoi atëherë kur gjuha filloi të shkruhej dhe u thye kështu uniteti i trupit, për shkak se nuk ishte më e domosdoshme përballja fizike për të komunikuar – duhet të rivlerësohen mënyrat e reja të ndërlidhjes. Dimensionin e ri, që fitojnë hapësira dhe koha në këtë kontekst kërkon një kodifikim përfshirë këtu rolin e individit-subjekt. Epoka e re në të cilën ka hyrë komunikimi kërkon modele të reja leximi, sepse një

¹ I. Sparapano, në studimin e saj “*La comunicazione cellulare: l’sms nell’oralità secondaria*”, thekson se shoqëria bashkëkohore, përcaktohet si shoqëria e oralitetit të dytë.

lexim i mirë i situatës në të cilën veprohet sot sjell një përballje të vetëdijshme të shartimeve të reja teknologjike.

Kontekstet e reja komunikative të ndërveprimit sinkron (*chat*, *sms*, etj.) dhe asinkron (*e-mail*, etj.) e zhvendosin rolin e gjuhës së shkruar në një plan tjetër të shumëfishtë, siç është monitorimi i vazhdueshëm, analiza dhe vënia në dukje e zhvillimeve përgjatë rrugëtimit të saj. Kristina Jorgaqi, në librin e saj *Leksione xhepi për gjuhën* vë në dukje “ndërrhyrjet nga lart, pra, ato që shoqëria i kryen në mënyrë të vetëdijshme ose, siç thuhet në gjuhësinë moderne, të planifikuara”, duke cilësuar se “vetë gjuha standarde është një produkt ndërhyrjesh të drejtpërdrejta të shoqërisë”. Megjithatë, gjuha standarde “vazhdon të zhvillohet e të kultivohet nën mbikëqyrjen e shoqërisë”,² pse jo dhe nën ndikimin e saj.

Tiparet e veçanta gjuhësore dhe semiotike që verifikohen në komunikimin sinkron e asinkron në rrjet mund të shihen nën dritën e një mënyre të ndryshme ndërveprimi, në një kontekst të ri të pakrahasueshëm me kontekstin “ballë për ballë”. “Duhet të përcjellësh mesazhe në pak hapësirë. Për më tepër, nuk bëhet fjalë për përcjellje informacioni thjesht, por edhe sjelljesh dhe emocione, të cilat në ndërveprimin ballë për ballë krejt natyrshëm dhe në mënyrë shumë domethënëse shprehen nga treguesit joverbalë”.³

Nga kjo pikëpamje është vënë re, se komunikimi i ndërmjetësuar trashëgon karakteristika që janë tipike edhe të gjuhës së folur edhe të gjuhës së shkruar. Për shembull, komunikimi i ndërmjetësuar asinkron – një formë e veçantë komunikimi me anë të së cilës mesazhet e përcjella dhe të marra nga pjesëmarrësit ndahen nga një interval kohor i vlerësueshëm edhe pse nuk mund të jepet një vlerësim sasior⁴ - mund të bashkëndajë me gjuhën e shkruar një strukturë sintaktike më komplekse, plot me fjali të varura pikërisht sepse asinkronia i lejon komunikuesit një kontroll më të vëmendshëm gjatë fazës së hartimit të mesazhit, si në rastin e komunikimit me mail.

E kundërta ndodh në komunikimin sinkron (*chat*, *sms* në disa raste). Afërsia me stilin e folur gjendet kryesisht në karakterin dialogjik, që është një cilësi dalluese e gjuhës së folur. Megjithatë, struktura komplekse e mesazhit në këtë rast varet edhe nga stili i shkruarit, nga tema për të cilën shkruhet, nga formimi i dërguesit dhe marrësit të mesazhit dhe nga faza në të cilën është event i komunikativ në një moment të caktuar.

Nga një tjetër pikëpamje, përse i përket gjuhës së ndërmjetësuar, ka një përqendrim të përdorimit më pak ceremonial të gjuhës dhe njëfarë klasifikimi të komunikuesve përse i përket pozicionit shoqëror. Në të shumtën e rasteve vihet re

² K. Jorgaqi, *Leksione xhepi për gjuhën*, Botimet Dudaj, Tiranë 2001, f. 146.

³ F. Ursini *Multimodalità nella scrittura? Gli sms tra telefoni cellulari*, in E. Magno Caldognetto/P. Cosi, *Multimodalità multimedialità nella comunicazione*, Unipress, Padova, 2001, f. 77.

⁴ A. Baracco, *La comunicazione mediata dal computer*, in M. Berretta, *Il parlato italiano contemporaneo*, in L. Serianni/P. Trifone(edd), *Storia della lingua italiana*, vol 2: *Scritto e parlato*, Einaudi, Torino, 1994, f. 256.

NDIKIMI I MEDIAVE TË REJA NË GJUHËN E SHKRUAR
RASTI I SHËRBIMIT TË MESAZHEVE TË SHKURTRA TË TELEFONISË
CELULARE

një stil bashkëbisedor, përdorimi i lokucioneve apo formave idiomatike, përdorimi i ironisë, i shenjave e simboleve të veçanta.

Flavia Ursini vë në dukje karakteristika interesante të mesazheve, pikërisht: “(...) modifikimin e një prej parametrave themelorë të situatës komunikative: ideja e një ndërveprimi të vërtetë zëvendësohet nga ideja e një teksti të botuar”; po këtu nga e njëjta autore vërehet se: “krijimtaria që karakterizon elementin verbal të sms-ve, të shtyn të mendosh për një krijueshmëri të vazhdueshme dhe në zgjerim, edhe pse brenda kufijve që lejon teknologjia dhe interpretimi”.⁵

Objekti i studimit. Objekti i këtij studimi është mënyra e komunikimit nëpërmjet sms-ve. SMS është akronimi për Sistemin e Mesazheve të Shkurtra (Short Message System).⁶

Shkruan gazetari italian Antonio D’Orrico: “Në redaksi, teksa më jepnin porositë, që janë kthyer në ritual para fillimit të pyetësorit më thanë: Kujdes, ki parasysh telefonat celulare dhe sms-të, aty po lind italishtja e së ardhmes, aty do të zbulosh të reja”.⁷

Shërbimi sms u bë veprues në vitin 1992 si një sistem komunikim-shërbimi nëpërmjet operatorëve të telefonisë celulare. Për shkak të zhvillimit të teknologjisë ndryshe prej fillimeve, shërbimet që sot ofron telefonia celulare janë të ndryshme, por theksoj, që në këtë studim është përqendruar vëmendja vetëm në shërbimin e mesazheve të shkruara dhe vetëm në disa tipare gjuhësore të tyre.

Korpusi. Korpusi mbi të cilin bazohet studimi përbëhet nga 470 mesazhe. Bëhet fjalë për mesazhe të shkëmbyera mes subjektsh që përfshihen në fashën moshore 14-15 vjeç. Për ndërtimin e këtij korpusi kanë ndihmuar klasat e nënta të dy shkollave nëntëvjeçare të kryeqytetit, ndërsa për mbledhjen e korpusit është vepruar si më poshtë:

Mesazhet kanë filluar të vilen nga tetori i vitit 2011, i cili përkonte pak a shumë edhe me fillimin e vitit të ri shkollor. Përjasja ndaj nxënësve është një pikë tjetër për t’u vënë në dukje. Meqenëse bëhej fjalë për vjeljen e mesazheve të cilat në përbërjen e tyre karakterizohen nga tipare të forta privatësie, herë-herë me të dhëna intime, afrimi i nxënësve nuk ishte i lehtë. Burimi i mesazheve duhej të ndihej i sigurtë që në asnjë rast nuk do të ishte i identifikueshëm si autor i mesazhit. Kam këmbëngulur në këtë pikë, mungesa e së cilës mund të dëmtonte cilësinë e korpusit, sepse mund të paraqiteshin mesazhe të stisura apo të modifikuara. Ishte thelbësore që mesazhet të ishin autentike, të paprekura, të

⁵ F. Ursini, *Multimodalità nella scrittura? Gli sms tra telefoni cellulari*, f. 77.

⁶ Ky është një shërbim, i cili lejon marrjen dhe dërgimin e teksteve që kanë një kufizim për sa i përket karaktereve. Me celularët e parë mund të dërgoheshin mesazhe deri në 160 karaktere, ndërkohë që sot, modeli më i përparuar arrin një numër të konsiderueshëm karakteresh.

⁷ A. D’Orrico, *L’italiano ai tempi degli sms*, *Corriere della Sera Magazine*, 3 shtator 2008, varianti on line.

pakorrigjuara, pra të vileshtin tamam ashtu siç ishin marrë apo dërguar. Vetëm kështu mund të kishim një panoramë të qartë rreth korpusit dhe veçorive të tij kryesisht gjuhësore, megjithëse mesazhet e vjela në të shumtën e rasteve riprodhojnë një situatë komunikative dhe si e tillë kërkon një shqyrtim më të gjerë, që e tejkalon aspektin mirëfilli gjuhësor. Për shkak të disa kufizimeve⁸ të korpusit nuk jam marrë me studimin e funksioneve shoqërore të këtyre sms-ve.

U është kërkuar nxënësve të transkriptojnë në një fletë A4 me kompjuter një korpus mesazhesh duke i shkëputur nga rubrika e veçantë (kujtesa e telefonit) ku ruhen mesazhet telefonike të dërguara dhe të marra. Transkriptimi në kompjuter ishte i parapëlqyer dhe do të ishte praktikë më e dobishme për hir të studimit, sepse gjuha e shtypur do lejonte identifikimin më me lehtësi të karaktereve si **o** dhe **a**, apo **m** dhe **n**. Pavarësisht porosive shumica dërrmuese e mesazheve kanë mbërritur të transkriptuar në fletë fletoreje; disa nxënës deklaruan që nuk kishin kompjuter, kurse disa të tjerë pohuan që kishin kompjuter, por jo një printer.

Janë porositur nxënësit që:

- gjatë transkriptimit mesazhi të përcillej i “paprekur”;
- të transkriptoneshin kryesisht mesazhe që përfshinin pyetje përgjigje, në mënyrë që të kishim idenë edhe mbi situatën komunikative mes dërguesit dhe marrësit;
- Të mbahej parasysh përcaktimi i gjinisë së marrësit dhe dërguesit, për të parë tipologjinë e ndikimeve në gjuhë sipas gjinisë;
- Të raportoheshin të gjitha llojet e mesazheve, përfshirë edhe mesazhe që kishin përmbajtje të papërshtatshme.

Përpunimi i të dhënave. Një ndër tiparet e sms-ve është përcjellja e mesazhit në atë pak hapësirë që ke në dispozicion. Përdoruesit nuk përcjellin thjesht informacione, por edhe sjellje dhe emocione që janë tipike të ndërveprimit ballë për ballë dhe që përçohen nga tregues joverbalë. Sistemi i mesazheve të shkurtra telefonike (SMS) nuk mundëson përdorimin e tipareve prosodike-intonative të modalitetit gjestual. Megjithatë përdoruesit ndiejnë nevojën t’i simulojnë këto tipare. Si rrjedhojë, është përpunuar një repertor zëvendësuesish, të cilët kushtëzohen nga aftësia e mjetit për të transmetuar.

Të tillë janë edhe *emoticons*: ikona dhe shenja grafike, të cilat, në bazë të një kodifikimi të bashkëndarë mes përdoruesve bëhen bartës dhe përcjellës të emocioneve, sjelljeve, qëndrimeve, etj. Një mënyrë e veçantë dhe shumë e përfolur kjo në komunikimin e ndërmjetësuar. Kohët e fundit vetë mjeti teknologjik është në gjendje të ofrojë *emoticons* më të përmirësuar nga ana e përfutimit emotiv. Në disa raste rezultojnë të jenë kaq të përpunuar sa bëhen të

⁸ Fillimisht, ishte menduar, që korpusi të përfshinte edhe klasën e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Në këtë mënyrë, kampioni do të kishte qenë më gjithëpërfshirës dhe përfaqësues. Megjithatë, për arsye bashkëpunimi, realizimi nuk ishte i thjeshtë. Dëshira mbetet për një studim tjetër më të zgjeruar.

NDIKIMI I MEDIAVE TË REJA NË GJUHËN E SHKRUAR
RASTI I SHËRBIMIT TË MESAZHEVE TË SHKURTRA TË TELEFONISË
CELULARE

vështirë për t'u interpretuar. Në korpusin e studimit është vënë re përdorimi i këtyre *emoticons*:

SHENJA	INTERPRETIMI	SHENJA	INTERPRETIMI
:)	buzëqeshje	: - *, xoxo	puthje
<3	të dua	☺	buzëqeshje, aprovim
^ - ^	i, e trishtuar	: -D	e qeshur

Këto janë shembujt që përsëriten më shpesh në korpusin e marrë në studim, megjithatë ka një listë të zgjeruar për përdorim ndërkombëtar e cila përfshin disa nga shenjat e mësipërme. Disa janë fryt i fantazisë së përdoruesve dhe pas një përdorimi të shpeshtë janë bërë pjesë e një liste të bashkëndarë për nga kuptimi.

Komunikimi i ndërmjetësuar nga kompjuteri (CMC – Computer Mediated Communication), paraqet disa veçanti ndër të cilat vlen për t'u përmendur ekonomia në përdorimin e gjuhës. Në artikullin e koleges Anila Çepani *Shqipja në internet* vihet në dukje se “përdorimi i komunikimit të drejtpërdrejtë me anë të mesazheve në Chat, në postat elektronike, MSN, si dhe një mori mënyrash të tjera, kanë bërë që gjuha e shkruar e atyre që përdorin internetin, të jetë shumë më e përmbledhur. Nevoja për t'u përgjigjur sa më shpejt bën që ata të përdorin një numër të pafund shkurtime, siglash, emotikonesh e shprehjesh anglisht, që janë më të shkurtra se fjalët përkatëse të gjuhës së tyre (në rastin tonë në shqip)”⁹.

Ky pohim vlen dukshëm në rastin e shërbimit sms. Kufizimi i karaktereve imponon njëfarë planifikimi. Në sistemin sms planifikohet më shumë se me teknologjitë e tjera. Detyrimi për t'u shprehur me pak karaktere nxit mënjanimin e anës formale të të shkruarit duke i kushtuar më shumë vëmendje përmbajtjes. Për arsye hapësire dhe kohe disa shkurtime bëhen gati të detyrueshme. Disa të tjera nga përdorimi i shpeshtë dhe nga kodifikimi i thjeshtë kthehen në vetvete në një fjalor lehtësisht të kuptueshëm, sidomos mes përdoruesve. E mëposhtmeja është një listë e shkurtimeve e pranishme në korpusin e studimit bashkë me shpjegimin përkatës.

SHKURTIMI	INTERPRETIMI	SHKURTIMI	INTERPRETIMI
Nsr	Nesër	Tkxh	Të kam xhan
X	për (italisht)	Skgj	S'ka gjë
Jm	Jam	Klm	Kalofsh mirë
Klb	kalofsh bukur	flm/shflm	faleminderit, shumë...
Njs	Nejse	Mhb	muhabet
Ncncnc	Mohim	Tdsh	Të dua shumë
Ckm	Ckemi	Dtl	ditëlindje
Cpb	Ca po bën	Cthngj	C'na thua ndonjë

⁹ A. Çepani, *Shqipja në internet*, Gjuha jonë, 26/2006, 1-4, f. 96-107.

RAFAELA MARTETA

			gjë...

Antonio D'Orrico në artikullin e lartpërmendur e quan këtë lloj komunikimi “dialogu i bashkëtingëlloreve në format telefoni celular”. Dhe ky nuk është pohim rastësor, sepse shumë studiues të tjerë kanë vënë re këtë veçori të komunikimit vetëm nëpërmjet bashkëtingëlloreve duke shuar zanoret në trup të fjalës.

Janë sjellë si shembull shkurtimet e përsëritura në mënyrë domethënëse në mesazhet e korpusit. Janë lënë mënjanë ato me karakter krejt personal e sporadik duke parapëlqyer paraqitjen e shkurtimeve që kanë krijuar njëfarë historie mes përdoruesve dhe kanë një bashkëndarje kolektive. Vërehet një fenomen kontradiktor: në shumë raste brenda të njëjtit mesazh, edhe pse ka një përdorim të spikatur të shkurtimeve nuk kursehen aspak shenjat e pikësimit: *Klb sot!!!!!!!* (shkëputur nga korpusi: Kalofsh bukur sot!!!!!!)

Përsa i përket pikësimit, një nga mjetet standarde të shkrimit tradicional dhe tipar i strukturimit të informacionit vërehet një përdorim shumë i madh i pikës. Kjo lloj shenje pikësimi tregon nevojën për mesazhe të shkurtra, si shenjë e vetë planifikimit që bën dërguesi. Për shembull: “*E di.*”, “*Kthe përgjigje.*”, “*Klm lalë*”. Ndër shenjat e tjera të pikësimit regjistrohet përdorimi i shumtë i pikëpyetjes, prania konsistente e së cilës konfirmon karakterin dialogjik të sms. Shembuj: “*Do takohemi nesër????*”, “*i ke bo det???*”, “*Ca bëre????*”; përdoret shumë shpesh pikëçuditësja, e cila gjendet e kombinuar dhe me shenja të tjera pikësimi (!?). Del kështu në dukje ana emocionale dhe vlerësuese e mesazheve. Në disa raste fjalja e tërë është një varg me pikëçuditje si më poshtë:

SITUATA 1	SITUATA 2
D: - provim nesër...	D: - tani po hap fb
M: - !!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!	M: - ☺
	D: - <3

Vërehet përdorimi i paktë i presjes funksioni i së cilës në shumë raste kryhet nga shumëpikëshi. Kjo shenjë (...) gjendet edhe në mes të fjalisë dhe në fund të saj. Shembuj nga korpusi: “*....pres babin...s'kam celës*”; “*Olta...Reni...Anamaria... m'a kaloni librin...nëse e ke...*”

Është vënë re zgjatimi i disa foneve që shprehin theksimin e disa gjendjeve emocionale apo sjellje si padurim, vlerësim. Kjo dukuri, që në mënyrë intuitive paraqitet me shumëfishimin e grafemave gjen shprehjen e vet në korpus nëpërmjet pasthirmave: “*ooooo Annaaaaaaaa*”, “*zemer*”, “*eejjjj ku jeeee*”; urimeve: “*gezuuaarr*”; përshëndetjeve: “*miremengjeeezzzz*”; vlerësimeve: “*shuuume buuuukur*”.

Shprehjet deiktike janë tregues se koha dhe hapësira e situatës komunikative perceptohen nga marrësi dhe dërguesi si të bashkëndara.¹⁰ Shprehjet

¹⁰ Në të vërtetë, nuk ka bashkëndarje të hapësirës (përfshijto rastet e rralla), por të kohës mes dërguesit dhe marrësit. Madje edhe koncepti “kohë” është pak problematik dhe nuk mund të thuhet se ka bashkëndarje të plotë të kohës, pasi varet nga kushtet e dërgimit të mesazhit. Nëse celulari është i hapur dhe nuk ka probleme të tjera teknike, koha e dërgimit

NDIKIMI I MEDIAVE TË REJA NË GJUHËN E SHKRUAR
RASTI I SHËRBIMIT TË MESAZHEVE TË SHKURTRA TË TELEFONISË
CELULARE

deiktike mund të jenë: përemra vetorë e dëftorë, ndajfolje vendi dhe kohe, shprehje që lidhen me përdorimin e urdhërores. Shembuj nga korpusi: “*menjeher*”, “*tani*”, “*jam ketu*”, “*po mberrij*”, “*a do dalim tani*”, “*prisni i cik aty*”, “*ja se mbaroj tani*”, “*po i them tashi*”, “*rruges jam tu ardh*”, “*ok, ik tani*”, “*m'kthe përgjigje tani, ktu ose nfb*”, “*Mprit aty se erdha...*”.

Zhargoni, i cili shpeshherë paraqitet si simbolik i një grupi të veçantë personash dhe shumë herë kthehet në arsye marginalizimi dhe përjashtimi, gjen hapësirë të konsiderueshme në korpus. Shembuj prej korpusit: “*kam ble 1 fustan te papam*”, “*yll fare...*”, “*a ke msu per provim lale?*”, “*sa e poshtun që je mi dreq*”, “*ome plako ca bone?*”, “*OME NONA NGA ISHE SOT M?*”, “*O plake hajde shpejt se jm jasht*”, “*Prit lal, avash*”.

Shuarja e apostrofit në rastet e domosdoshme dhe përdorimi i pavend i tij janë domethënëse në korpus: “*smle mami*”; “*sma ha menja*”; “*nshpi*”; “*tka ngacmu njeri*”; “*sdu*”; “*svija dot*”; “*skam nerva*”. Raste të përdorimit të pasaktë: “*po me c'mend fare*”; “*c'ka*”; “*c'fare*”. Ndërkohë është e dukshme mungesa ë-së fundore¹¹ dhe në trup të fjalës. Gjenden në formën pa ë-fundore foljet: *qoft, pash, vazhdojm, ndajm, antarsu, humb, nis, ndejt, ngrit* (me vlerën e pjesores dialektore); emrat: *pun, or, klas, kimin, dit, bank, shkoll, fiziks*; ndajfoljet: *ktu, menjihet, shum, jasht, mir, von, mbar*; mbiemra: *e mbar, i mir*. Po ashtu përemri vetor “*unë*” gjendet pothuajse gjithmonë në formën pa ë-fundore.

Ndër të tjera është për t'u vënë në dukje edhe përdorimi i shkronjës së vogël për emrat e përveçëm. Rastet në korpus nuk janë domethënëse, për më tepër kur shumica e tekst-mesazheve është e shkruar ose me shkronja të mëdha ose me shkronja të vogla. Vihet re që shumë përdorues, kur vendosin të përdorin shkronjën e vogël e ruajnë atë edhe në fillim të fjalisë për emrat e përveçëm, për emrat e shteteve apo qyteteve. Ndodh shpesh, që në një tekst të shkruar plotësisht me shkronja të vogla, ndërfitet përdorimi i shkronjës së madhe përgjatë gjithë trupit të një fjale të caktuar kur synohet theksimi i saj në një moment të caktuar të situatës komunikative:

SITUATA 1	SITUATA 2
M: ca po bo???	D: hape telin or dreq se jam ORI...
D: hic po shof GYMYSHIN	D: ke nder mend ta hapesh ate dreq teli se na ACAROVE...

është rreth 6 sekonda. Megjithatë përdoruesit e konsiderojnë një mjet të menjëhershëm të dërgimit të mesazheve.

¹¹Grafikisht ë- fundore nuk gjendet në asnjë prej mesazheve, duke qenë një karakter që duhet kërkuar ndër simbolet e veçanta. Për arsye të shpejtësisë së komunikimit, edhe ë edhe ç janë shuar dhe zëvendësuar respektivisht me e dhe c. Prandaj kur flitet për mungesë të ë-së fundore biem dakord, në rastin e komunikimit me sms, që bëhet fjalë për mungesë të e-së fundore.

Vlen të vihet në dukje përdorimi i gjuhës së huaj në korpus. Gjuha e përdorur më së shumti është anglishtja, megjithëse bëhet fjalë për një leksik të reduktuar, zakonisht janë fjalë e shprehje urimi: *“Happy New Year, baby!!!!**”*, *“Happy birthday”*; vlerësimi, dashurie, përshendetje: *“kisss for you”*, *“you are beautiful”*, *“Honey!”*, *“love you much”*, *“bye”*; terma për lojrat sportive: *paintball*, *calceto*. Gjenden në korpus edhe shprehje të përziera, ku fjala e huaj përshtatet më gjymtyrë të tjera në shqip ose e kundërta: *“Zemer luv u, naten”*, *“ik ore, ti je crazy”*, *“bye zemra”*, *“love u shuuume”*.

Së fundmi, një tjetër tipar i gjuhës së ndërmjetësuar me sms është përzjerja e shifrave me shkronja edhe në rastet kur, për hir të drejtshkrimit, rekomandohet përdorimi i shkronjave.¹² Shembuj nga korpusi: *“Vin anej nga ora 5, mi”*, *“kot mi du me t’thon 1 mhb”*, *“Ej, po iki 1her se kom 1 pun.”*, *“ok, takohemi ne 4”*, *“kam 2hr... pse ?:D”*, *“kam ble 1 fustan tpapam”*, *“Jo, nuk takohemi dot se kam 1 pun”*.

Përfundime. Studimi ka synuar përshkrimin në vija të trasha të tipareve më domethënëse të korpusit kushtëzimet e të cilit u përmendën që në fillim. Veçoritë gjuhësore që shfaq ky korpus nuk janë të përgjithësueshme edhe për vetë faktin se kemi të bëjmë më një studim rasti. Do të ishte interesant një studim më gjithëpërfshirës mbi argumentin për të vërejtur se cilat tipare nga të lartpërmendurat shtrihen dhe ruhen e cilat shuhën.

Ajo çka nuk mund të vihet në dyshim është se kemi të bëjmë më një mënyrë krejt të re e të veçantë ligjërimi dhe komunikimi, e cila për momentin nuk prek fushën e komunikimit publik, por pa dyshim, prek sjelljet dhe qëndrimet tona ligjërimore. Askush nuk mund të na sigurojë, se në një afat të gjatë kohor kjo mënyrë e re komunikimi nuk do të krijojë një tjetër mendësi ligjërimore. Mbeten për t’u përcaktuar kriteret, ndërkohë që zilet e alarmit kanë rënë. Gjithsesi, nuk është për t’u nënvlerësuar krijueshmëria e përdoruesve të mjetit.

Ka plot aspekte të tjera të cilat ngjallin interes për një vazhdim të studimit në një spektër më të gjerë: rivlerësimi i hapësirës dhe kohës, rivlerësimi i një paradigme të vjetër që e sheh gjuhën thjesht si instrument për të përcjellë informacion, kur në të vërtetë ajo ka funksione të shumëfishta.

Natyra e veçantë e ndërmjetësit, celularit në këtë rast, e bën të pamjaftueshme dikotominë e thjeshtë gjuhë e folur/gjuhë e shkruar. Është e domosdoshme që kjo skemë të përshtatet duke e afruar me forma të tjera më të ndërmjetme dhe të përziera dhe vlerësimit të çdo situatë komunikative. “Nuk mjafton që klasifikimi i ligjëritimit të bëhet në bazë të mjetit të transmetimit: sot

¹² Kristina Jorgaqi, në librin e saj *Thërmija gjuhësore* rekomandon që “kur bëhet fjalë për shifra të ulëta, që tregojnë sasi të çikaje, do të ishte mirë që shifrat të jepeshin me shkronja”. Po ashtu rekomandon edhe për raste kur duhet të tregohet ora me shkrim “(...) nëse riprodhojmë një bisedë, rrëfjmë një ngjarje, shkruajmë një letër, bëjmë një pusullë, dërgojmë shënim urimi etj., shifrat duhen shmangur. Shifra të lë gjithmonë shijen e çikaje teknike, të thatë, pa ngjyrë, pa shprehje, çka do të thotë se ajo nuk i shkon për shtat stilit bisedor, atij rrëfëmtar etj.”, Botimet Ora, Tiranë 2003, f. 90-91.

NDIKIMI I MEDIAVE TË REJA NË GJUHËN E SHKRUAR
RASTI I SHËRBIMIT TË MESAZHEVE TË SHKURTRA TË TELEFONISË
CELULARE

shumë autorë i referohen një modeli konceptual, që qëndron midis gjuhës së folur dhe të shkruar. Gjuha e folur herë-herë mund të marrë trajta konceptuale të gjuhës së shkruar dhe disa lloj shkrimesh kombinohen me aspekte oraliteti.¹³

BIBLIOGRAFI

- BARACCO, Alberto, *La comunicazione mediata dal computer*, in M. Berretta, Il parlato italiano contemporaneo, in L.Serianni / P. Trifone(edd), Storia della lingua italiana, vol 2: Scritto e parlato, Einaudi, Torino, 1994.
- CEPANI, Anila, *Shqipja në internet*, Gjuha Jonë, 26/2006, 1-4, f. 96-107.
- D'ORRICO, Antonio, *L'italiano ai tempi degli sms*, Corriere della Sera Magazine, 3 shtator 2008, varianti on line.
- JORGAQI, Kristina, *Leksione xhepi për gjuhën*, Botimet Dudaj, Tiranë 2001.
- JORGAQI, Kristina, *Thërmija gjuhësore*, Botimet Ora, Tiranë 2003.
- URSINI, Flavia, Multimodalità nella scrittura? Gli sms tra telefoni cellulari, in E Magno Caldognetto / P.Cosi, Multimodalità multimedialità nella comunicazione, Unipress, Padova, 2001.
- BELTRAMO/ NESCI, *Dizionario di stile e scrittura*, Zanichelli, Bologna, 2011.

¹³ F. Ursini, Multimodalità nella scrittura. Gli sms tra telefoni cellulari, f. 75.